

**AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE****PËRGJIGJET E KËRKESAVE TË TESTIT  
(SKEMA E VLERËSIMIT)****Shkolla e mesme e përgjithshme- drejtimi natyror.**

Sesioni I, 9 qershor 2008

**Varianti A***Udhëzime të përgjithshme:*

- Testi përbëhet nga dy pjesë: një prozë dhe një poezi
- Testi përmban një total prej 50 pikësh
- Testi ka 25 pyetje. 13 me alternativa dhe 12 me zhvillim
- Skema parashikon mundësitë e përgjigjeve
- Skema tregon specifikimet për secilën pikë në të njëjtën pyetje
- Në pyetjet me disa mundësi është e rëndësishme që nxënësi të thotë të paktën një të njënjë prej mundësive.
- Vlerësimi i pyetjes 12, është specifikuar me kujdes, duke pasur parasysh që është një pyetje ese.
- Skema nuk konsiderohet përfundimtare. Kjo do të thotë që për pyetje të caktuara nxënësi mund të sjellë përgjigje të cilat nuk janë parashikuar në skemë, por gjejnë kuptim në përputhje me pyetjen dhe logjikën e saj
- Saktësia gjuhësore ndikon në vlerësimin e nxënësit, kur ka përsëritje të theksuara gabimesh ose ka gabime të cilat prishin kuptimin e shprehjes.

*Skema e përgjigjeve:***Pjesa e I      Letër Babait**

<b>Pyetja 1</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 2</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 3</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 4</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 5</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 6</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>

**Pyetja 7      1 pikë**

- I pambrojtur, ose një fjalë sinonime ose e afërt nga kuptimi me të.

**0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar.**Pyetja 8      3 pikë****8/a** Bota e skllavit, ose bota e skllavit ndërtohet nën trysninë e urdhrave.**8/b** Bota e urdhërave, bota e largët e urdhrave, që ngjallte frikë.**8/c** Bota e lirë, bota e lumtur, ku njerëzit nuk i bindeshin askujt.**2 pikë** Kur gjen dy nga botët.**1 pikë** Kur gjen vetëm një të njënjë.**0 pikë** Kur nuk gjen asnjë të njënjë.

**Pyetja 9 2 pikë**

**9/a Nënteksti:** ton tallës, nënteksti; je njeri i trashë, i keq, mashtrues, dinak, përdor dhuntitë e tua për të bërë keq.

**9/b Figura:** Ironia.

**1 pikë** Kur thotë vetëm nëntekstin, ose vetëm figurën.

**0 pikë** Kur jep përgjigje të gabuar.

**Pyetja 10 4 pikë.**

- Realiteti shfaqet brutal, arbitrar, i ngurtësuar, realitet frike, me mungesë lirie, etj

- Fakte: fyerjet e tua, vrisje e prisje, urdhëroje, nuk kurseje askënd, etj

- Opinioni: babai sipas autorit, ka gabuar fund e krye.

- Lidhjet janë: shkak-pasojë, një sjellje e keqe çon në një sistem edukimi të gabuar, ç'edukues, të nënshtruar, armiqsor, hipokrit, etj.

**3 pikë .** Nëse nxënësi jep nga një përgjigje, për tre kërkesa.

**2 pikë** Nëse nxënësi jep nga një përgjigje për dy kërkesa .

**1 pikë** Nëse nxënësi jep një përgjigje, për një të kërkesat.

**0 pikë** Nëse nuk përgjigjet fare, ose ka përgjigje të cilat nuk afrojnë me mundësitë e kërkesave.

**Pyetja 11 2 pikë**

**11/a Urdhëroje, caktoje(urdhra).**

**11/b Drejtoje, zemëroheshë.**

**1 pikë** Kur jep vetëm një të kërkesat nga foljet.

**0 pikë** Kur nuk përgjigjet fare, ose kur jep përgjigje të tjera.

**Pyetja 12 8 pikë**

**12/a Shtjellimi i idesë 2 pikë . Duhet të kihet parasysh:**

- Fokusimi në temë, përshtatja me qëllimin e temës.

- Renditja e ideve.

- Të argumentojë mendimin e tij mbi pohimin, të ilustrojë me shembuj.

**1 pikë** Nëse nxënësi jep mendim mbi temën, por nuk e argumenton atë.

**0 pikë** Kur shkruan diçka të pakuptueshme.

**12/b Organizimi dhe struktura 2 pikë . Duhet të kihet parasysh:**

- Pjesët përbërëse( hyrje, zhvillim, mbyllje).

- Kronologjia( rend të mendimit dhe ideve, të shembujve që jep).

- Logjika( të ketë lidhje me çfarë është thënë më parë nga ai ose në fragment).

- Kalimet e kuptimshme ( nga njëra pjesë në tjetrën).

**1 pikë** Kur respekton vetëm strukturën e esesë.

**0 pikë** Kur struktura nuk të jep asnjë kuptim.

**12/c Stili dhe origjinaliteti. 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:**

- Shprehjet origjinale ( figuracioni, fjalë jo të zhargonit të përditshëm).
- Nëse stili është i gjallë, tërheqës, ndikues. (me rrjedhshmëri , të ketë efekt)
- I qartë.
- Jo imitues,( të mbështetet te autori, por të japë dhe mendimin e tij.

**1 pikë** Kur thotë diçka të vetën, por pa larmi, pa bukuri, pa shumë qartësi.

**0 pikë** Kur nuk kuptohet asgjë nga ajo që ka thënë.

**12/d Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:**

- Trajta e duhur e fjalëve.
- Fjali të sakta.
- Shenjat e pikësimit.
- Shkronja e madhe.

**1 pikë** Kur ka gabime, por përcjell kuptim mbi temën dhe ide..

**0 pikë** Kur gabimet e shumta deformojnë ose nuk lejojnë kuptimin e shprehjes.

**Pjesa e dytë Serafina Topia.**

**Pyetja 13 A 1 pikë**

**Pyetja 14 D 1 pikë**

**Pyetja 15 C 1 pikë**

**Pyetja 16 A 1 pikë**

**Pyetja 17 A 1 pikë**

**Pyetja 18 A 1 pikë**

**Pyetja 19 D 1 pikë**

**Pyetja 20 2 pikë**

- **Historikë:** Gjon Kastrioti, bija e Aranitit, Vojsava.

- **Të trilluar:** Serafina, Niku, Bozdari.

**1 pikë** Kur thotë vetëm një personazh, ose dy nga njëjti lloj..

**0 pikë** Kur nuk thotë asnjërin nga ata në skemë.

**Pyetja 21 4 pikë**

**Nxënësi mund të përmendë këto tipare:**

- Lloji i poemës
- Shkrija e poetit me heroin lirik.
- Mbështetja në folklore (emërtimi trim, motivi i mikpritjes, i besës, roli i të parit të fisit, 8-rrrokëshi)etj.
- Evokimi i së kaluarës (koha e Kastriotëve, Skënderbeut).
- Idealizimi i personazheve të tij (të bukur, të mençur, trima, kryelartë etj).

**3 pikë.** Kur jep dy tipare, shoqëruar me një shembull.

**2 pikë.** Kur jep një tipar me një shembull, vetëm dy tipare, ose vetëm dy shembuj.

**1 pikë.** Kur jep një tipar, ose vetëm një shembull.

**0 pikë.** Kur nuk thotë asnjë, ose jep përgjigje që nuk kanë lidhje me romantizmin..

**Pyetja 22 2 pikë**

**22/a** - tehprehta, fytyrprera.

**22/b** - shqepzëngritur.

**1 pikë.** Kur jep njërin nga epitetet.

**0 pikë.** Kur gjen epitetin e gabuar.

**Pyetja 23 2 pikë**

- Funksion nxitës.

- Mënyra urdhërore.

**1 pikë.** Kur gjen funksionin, ose mënyrën e foljes.

**0 pikë** Kur nuk gjen asnjërin.

**Pyetja 24 3 pikë**

**24/a** Atmosfera e dasmës në shtëpinë e Kastriotëve.

**24/b** Dyluftimi midis Nikut dhe Bozdarit, ndërhyrja e Vojsavës.

**24/c** Roli i Serafinës në zgjidhjen e situatës dramatike.

**2 pikë.** Nëse nxënësi jep kuptimin e dy prej fragmenteve.

**1 pikë.** Nëse jep kuptimin e një fragmenti.

**0 pikë.** Nëse nuk jep asnjërin ose përgjigje të gabuar.

**Pyetja 25 4 pikë**

- Situata është dramatike sepse: kemi ndeshjen midis dy trimave, ose heronjve.

Dyluftimi ndodh në një dasëm dhe në familjen e Kastriotëve.

- Roli i grave është zbutës, ekuilibrues, zgjidh konfliktin.

- Kjo duket, kur Vojsava vendos duart në armët e trimave dhe kur Serafina largon me kujdes të shoqin nga dasma, për të mos fyer sofrën e mikpritjes.

**3 pikë** Nëse nxënësi përshkruan situatën dhe thotë vetëm rolin e njëres prej grave. Nxënësi thotë rolin e dy grave bën një përshkrim jo të plotë të situatës.

**2 pikë.** Kur nxënësi thotë vetëm rolin e grave, ose vetëm përshkrimin.

**1 pikë.** Kur flet për rolin e njëres prej grave, ose kur bën vetëm pak përshkrim.

**0 pikë.** Nëse nxënësi përgjigjet në mënyrë të pakuptueshme, ose jep përgjigje të gabuar.